



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1711/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Regjionale e Mbeturinave “Uniteti” Sh.a , me nr. Biznesi 70465104, rr. Vëllezërit Dragaj, ne Mitrovicë, ndaj debitorit “Emona” shpk, Depo me NUI 810693293 rr.” Kongresi i Manastirit” ne Vushtrri, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës–Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2520/22 datë 29.09.2023, me datën 08.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditorit Kompania Regjionale e Mbeturinave “Uniteti” Sh.a, me nr. Biznesi 70465104, rr. Vëllezërit Dragaj ne Mitrovicë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës – Dhoma e Shkalles se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2520/22 i datës 29.09.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës–Dhoma e Shkallës se Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2520/22 dt.29.09.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit “Emona” shpk, Depo me NUI 810693293 rr.” Kongresi i Manastirit” ne Vushtrri dhe e ka anuluar urdhrin përmbarimor P.nr.1118/22 dt.24.10.2022, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Atip Mustafa me seli ne Mitrovicë, dhe ka përfunduar procedurën ne këtë çështje përmbarimore.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, për shkak të vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkallës se dytë ta prish aktvendimin e atakuar te gjykatës se shkallës se parë.

Në përgjigje në ankesë debitori deklaroi se borxhi i kërkuar nga kreditori nuk ka bazë ligjore dhe i propozon gjykatës që ti refuzoj pretendimet ankimore të kreditorit dhe ta lë në fuqi aktvendimin e atakuar.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Regjionale e Mbeturinave “Uniteti” Sh.a , me nr. Biznesi 70465104, rr. Vëllezërit Dragaj, ne Mitrovicë, me datën 24.10.2022, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit “Emona” shpk, Depo me NUI 810693293 rr.” Kongresi i Manastirit” ne Vushtrri, në bazë të dokumentit të besueshëm - Ekstraktit te verifikuar nga librat afarist te kontabilitetit VU.B.50.4270. Përmbartuesi Privat Atip Mustafa nga Mitrovica sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.1118/22 dt.24.10.2022, ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër te përmbushjes se detyrimeve sipas dokumentit te besueshëm, kreditorit ti paguaj shumën prej 1,596.77 euro, me kamatë ligjore prej 8% llogaritur nga data e paraqitjes se propozimit për përmbartim e deri te pagesa definitive si dhe shpenzimet e procedurës.

Kundër urdhrit përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim, me pretendimin se me kreditorin nuk ka lidhur kontrate bashkëpunimi, kartela financiare nuk përmban vulën e as nënshkrimin e debitorit ashtu qe nuk është dokument i besueshëm, sipas nenit 29 të LPP, shton se pasi debitori është person juridik dokumenti duhet te jete i vulosur me vulë dhe i nënshkruar nga debitori, elemente këto qe mungojnë ne dokumentin e prezantuar. Kreditori duhet ta argumentoj faktin se këto fatura janë te papaguara nga debitori, andaj propozon qe gjykata ta aprovoj prapësimin e debitorit dhe ta shfuqizoj urdhrin përmbartimor si dhe ta obligoj kreditorin ti paguaj shpenzimet e përmbartimit.

Përgjigje në prapësim ka paraqitur kreditori me arsyetimin se ekstrakti mbi te cilin është mbështetur propozimi për përmbartim përmban te dhënat e sakta lidhur me debitorin duke u mbështetur ne frymën e nenit 40 te LPP, propozon qe gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit dhe urdhrin përmbartimor ta lë në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës- Dhoma e Shkallës se parë, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin KPPP, nr.2520/22 dt.29.09.2023, me të cilin ka vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Ka gjetur se ekstrakti i verifikuar nga librat afarist nr.VU.B.50.4270 ne te cilin mbështetet propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore për te qenë dokument i besueshëm sepse ne këtë dokument nuk është përcaktuar saktë objekti i detyrimit dhe nuk mund te konstatohet se për cilat periudha kohore është krijuar dhe është kërkuar përmbushja e borxhit nga debitori, ky dokument nuk ka tipare te përmbartueshmërisë, e kjo sepse borxhet e akumuluar ne fund te secilit vit nga viti 2013 deri ne vitin 2022 janë bartur nga viti ne vitin pasues me përshkrimin *Carried over from the*, duke u fatuar si borxh i ri.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata shkalles se dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e shkalles se Dytë, bazuar nga shkresat ne lëndë konstaton se propozimi për përmbarrim është lejuar ne bazë të nenit 29 par.1 nenpar.1.2 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore nr.04/L-139, sipas te cilit dokument i besueshëm janë edhe *”Ekstraktet e verifikuara nga librat afariste, për pagesa të shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*-konkretisht ne rastin konkret Ekstraktit nr. VU.B.50.4270, për shumën e detyrimit prej 1,596.77 euro. Mirëpo kjo gjykatë analizuar propozimin për përmbarrim të kreditorit dhe ekstraktin e verifikuar nga librat afarist VU.B.50.4270 si dokument mbi bazën e te cilit është lejuar përmbarrimi, konstaton se i njëjti nuk përmban elementet e kërkuara me dispozita ligjore përkatësisht nenin 29 par.3 te LPP i cili përcakton se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbarrim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar”*, e që në rastin konkret është e paqartë se cila është shuma e saktë e detyrimit te përcaktuar si ne propozimin për përmbarrim sipas këtij ekstrakti të bashkëngjitur nga kreditori, sepse kjo shumë në këtë ekstrakt është e bartur që nga data 01.01.2013 e duke vazhduar të bartet më tutje nga viti ne vit e deri ne vitin 2022, me çka nuk mund të konstatohet saktë detyrimi i krijuar nga debitori për periudhën e caktuar kohore, përmbushjen e te cilit e kërkon kreditori. Andaj mbi këtë bazë kjo gjykate e pranon përfundimin juridik te gjykatës e shkallës së parë lidhur me gjendjen faktike të konstatuar nga e njëjta.

Kjo gjykatë ka analizuar edhe pretendimet e kreditorit por të njëjtat vlerësoj se nuk janë relevante për një vendosje ndryshe, ashtu që i ka refuzuar ndërsa aktvendimin e atakuar e ka vërtetuar.

Përndryshe, në procedurën përmbarrimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarrimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarrues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbattoj përmbarrimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë, për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.1711/23 me datë 08.05.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha